

VENDIM
Nr. 274, datë 17.4.2026

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit “Lista e OKB-së”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”, shtohen 3 (tre) individë të renditur në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë të organizatave ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi

SHTESA NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
 (“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-QAIDA*

a) Shtesa në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”;

1. SAMI: JASIM: MUHAMMAD JAATA: AL-JABURI
2. ABD EL HAMID: SALIM: IBRAHIM BRUKAN: AL-KHATOUNI
3. HAMIDAH: NABAGALA

Shënim. Gjenealogjet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.